



Në mbështetje të nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen 36-të të mbajtur më 26.08.2015, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji i Menaxhmentit Internacional “Globus” për periudhën tre vjeçare, 1 Tetor 2015 – 30 Shtator 2018:
 - Financa dhe Banka, BA (180 ECTS);
 - Kontabilitet dhe Auditim, BA (180 ECTS)

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara me lartë, raportin final të hartuar nga ekipit i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, dhe bazuar në Udhëzimit Administrativ për Akreditim 02/2013, datë 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Institucioni i juaj është i obliguar që të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i ekspertëve (në të dy gjuhët, shqip dhe anglisht dhe në të dy versionet, të shtypur dhe elektronik në CD) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim deri më 30 Tetor 2015.

Këshilla juridike: Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas afatit të përcaktuar me Ligjin mbi Procedurën Administrative Nr. 02/L-28, datë 22 korrik 2005.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi u dërgohet:

- Kolegjit i Menaxhmentit Internacional “Globus”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë